

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA GLLOGOC**

Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	611-25-498-1-3-6
Nr i brendshëm	611-25-002-136

Sa i përket tenderit për: **Furnizim me barëra dhe material shpenzues mjekësor.**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

**MESE PHARM SH.P.K.**

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

**Magjistrallja Prishtine - Podujeve, pn**

(Adresa)

**Prishtinë**

(Vendi)

**10000**

(Kodi postar)

**+38344122204**

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

**Valdet Jupolli**

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

**mesepharm@gmail.com**

(Adresa elektronike)

**28.03.2025**

(Data e parashtrimit të ankesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

\_\_\_\_\_  
(Emri i avokatit)

\_\_\_\_\_  
(Adresa e plotë)

\_\_\_\_\_  
(Numri i Telefonit)

\_\_\_\_\_  
(Numri i faks-it)

\_\_\_\_\_  
(Adresa elektronike)

\_\_\_\_\_  
(Data e parashtrimit të ankesës)

\_\_\_\_\_  
(Nënshkrimi dhe vula)

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

Data e njoftimit për kontratë: 05.02.2025 Hapja e ofertave: 10.02.2025 Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 27.02.2025 Kërkesa për rishqyrtim dt: 03.03.2025 Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim: 18.03.2025
---

## 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po ☐

Jo ☒

## 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po ☒

Jo ☐

## 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

*A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?*

Po ☒

Jo ☐

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Neni 1 i LPP-së  
Neni 7 i LPP-së  
Neni 52 i LPP-së  
Neni 56 i LPP-së  
Neni 59 i LPP-së  
Neni 60 i LPP-së  
Neni 61 i LPP-së  
Neni 69 i LPP-së  
Neni 72 i LPP-së  
Neni 4 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik  
Neni 41 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik  
Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik.

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Data e njoftimit për kontratë është bërë me dt.05.02.2025, kurse hapja e ofertave është bërë me dt. 10.02.2025 ku kanë qenë dy ofertues.

Njoftimi mbi vendimin e AK-së ishte bërë me dt. 27.02.2025 është rekomanduar për kontratë OE “BRT Pharm SHPK”, me çmim prej 8,397.20 €, ndërsa ne jemi shpallur si tenderues i pasuksesshëm.

Pas publikimit të formularit B58 njoftimi mbi vendimin e AK-së, ne kemi kërkuar qasje në dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë dhe kemi vërejt se oferta e këtij OE është me çmime jo normalisht të ulëta dhe me çmime manipulative.

**Çmime jo normalisht të ulëta janë ofruar në pozicionet si më poshtë:**

13	Pej najllan Nr. 3.0 (1x12c)	pako	7	0.80	5.60
14	Pej najllan Nr. 5.0 (1x12c)	pako	2	0.80	1.60

Çmimet e penjve siç parashihen në pozicionin 13 dhe 14 në treg gjenden me 7 euro një kuti/Pako, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar çmim prej 0.80 €.

Nuk ka asnjë mundësi që të gjendet në treg kutia me çmimin që e ka ofruar OE i rekomanduar për kontratë, prandaj ky OE është i papërgjegjshëm. Është shumë e çuditshme që si autoriteti kontraktues të paktën nuk ka kërkuar sqarime për këto pozicione kur dihen çmimet e tregut për këta produkte. Me këtë rast AK-së nuk ka respektuar nenin 61 të LPP-së dhe nenin 41.4 të RRPP Nr.001/2022, duke mos kërkuar fare sqarime për këto pozicione. Pra kemi mosrespektim të procedurave ligjore në këtë rast.

**Gjithashtu AK-ja nuk ka vepruar konform procedurave ligjore për faktin se nuk ka përdorur procedurë inter partes me OE të rekomanduar për kontratë për shqyrtimin e tenderit i cili është jo-normalisht i ulët.**

Çmimet manipulative dhe më të larta se sa çmimet e tregut OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar në pozicionet e Paramasës, si më poshtë:

29	Grav test HCG (Kasetë)	copë	100	3.30	330.00
36	Steri-strip adhesive 6mm X 75mm	copë	100	2.60	260.00

Çmimi i produktit në treg për pozicionin 29 është përafërsisht 0.15 €, pra 15 cent, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmim prej 3.30 €.

Ndërsa për pozicionin 36 çmimi i këtij produkti në treg gjendet rreth 0.10 €, kurse OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmim prej 2.60 €.

Këto dëshmi tregojnë për favorizim të OE të rekomanduar për kontratë me rastin e rekomandimit për kontratë.

Në këtë rast autoriteti kontraktues nuk është kujdesur që çmimet ofertuese të jenë në harmoni me çmimet e tregut edhe pse AK-së ka obligim ligjor.

#### **Neni 4.1 i RRPP Nr.001/2022 pika C, e përcakton qartë:**

Gjatë administrimit të procedurave të prokurimit, Autoriteti Kontraktues do të ketë obligimet në vijim:

c. të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut.

Në këtë rast, nuk janë zbatuar këto dispozita, prandaj OE i rekomanduar për kontratë është dashur të shpallet papërgjegjshëm, sepse në pozicionet e cekura më lartë çmimet e këtyre produkteve janë ekstrem më të larta se sa çmimet e tregut dhe mund të kemi dëmtim të buxhetit me këto çmime.

Ne me dt.18.03.2025 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, ku AK-ja është arsyetuar se kërkesa është e pa bazuar, mirëpo nuk janë dhënë fakte konkrete për një refuzim të tillë.

AK-ja në arsyetimin e saj e ka cekur si në vijim:

Autoriteti Kontraktues ka bere vlersimin e lendes konform LPP dhe RRUOP dhe komisioni I vlersimit nuk ka konsttauar qe ka cmime qe nuk jane te perafarta me cmimet ne treg . Oferta eshte brenda vleres se parashikuar dhe si procedure ka qene me urgjente pasi qe procedura tjeter ka qene ne OSHP . Andaj duke u bazuar ne pretendimet e me larta kerkesa per ri-shqyrtim eshte e pabazuar .

Ky arsyetim i AK-së është i pa bazuar dhe i paqëndrueshëm për faktin se ne e kemi sqaruar qartë se çmimet me të cilat ka ofertuar OE i rekomanduar për kontratë nuk janë çmime të tregut ku në disa pozicione janë dhënë çmime më të ulëta se sa çmimi i tregut, ndërsa në pozicione tjera çmimet janë shumëfish më të larta se çmimi i tregut.

Autoriteti kontraktues vendimin e saj nuk e ka arsyetuar fare dhe njëkohësisht nuk e ka mbështetur në fakte, konkrete mirëpo vetëm e ka cekur së sipas komisionit të vlerësimit nuk është konstatuar që çmimet nuk janë të përafërta me çmimet e tregut dhe se oferta është brenda vlerës së parashikuar. Ky arsyetim i AK-së është dashur të mbështetet në fakte konkrete dhe të prezantohen dëshmi se ku janë bazuar që çmimet janë çmime të tregut, mirëpo një gjë të tillë nuk kanë mundur ta bëjnë pasi që konstatimi i tillë nuk qëndron, sepse nëse do të ishte i qëndrueshëm një konstatim i tillë atëherë do të prezantoheshin fakte konkrete.

Ndërsa sa i përket faktit që oferta është brenda vlerës së parashikuar, ky arsyetim i absurd sepse pa marr parasysh faktin që oferta është brenda vlerës së parashikuar ligji i prokurimit publik dhe RRPP përkatësisht Neni 4.1 i RRPP Nr.001/2022 pika C, e përcakton qartë:

*Gjatë administrimit të procedurave të prokurimit, Autoriteti Kontraktues do të ketë obligimet në vijim:*

*c. të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut.*

*Në këtë rast, nuk janë zbatuar këto dispozita, prandaj OE i rekomanduar për kontratë është dashur të shpallet papërgjegjshëm, sepse në pozicionet e cekura më lartë çmimet e këtyre produkteve janë ekstrem më të larta se sa çmimet e tregut dhe mund të kemi dëmtim të buxhetit me këto çmime.*

Kur kemi parasysh faktet e lartcekura kuptohet qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është i pa bazuar dhe i paqëndrueshëm.

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është bërë ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së, pasi që është rekomanduar për kontratë OE i papërgjegjshëm, ndërsa ne duhet të jemi fitues i këtij tenderi sepse jemi të përgjegjshëm dhe jemi me çmim më të lirë në krahasim me ofertuesin e përgjegjshëm.

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, ndërsa paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Në këtë rast ne nuk jemi trajtuar në mënyrë të barabartë por jemi diskriminuar. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse”, mirëpo në këtë rast AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore sepse oferta e OE të rekomanduar për kontratë nuk i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.

Gjithashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke pasur parasysh të gjitha arsyet ligjore që u përmendën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

## **VENDIM**

- I. APROVOHET**, e bazuar ankesa e OE **MESE PHARM SH.P.K**
- II. ANULOHET**, njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në RIVLERËSIM dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-s.

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 1,000.00 euro.

## v10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*